



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

**Raport individual për rezultatin e konsultimit publik për
Projektligjin “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”**

1. Titulli i projektligji

Projektligj “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”¹

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Procesi i konsultimit filloi me publikimin në RENJK sipas legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik në periudhën 01.12.2023, deri më 28.12.2023.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit të përdorura për Projektligjin “Për Patentat, Modelet e Përdorimit dhe Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë”, janë si më poshtë vijon:

¹ Objektivat kryesore që projektligji synon janë:

1. Rregullimi i plotë i marrëdhënieve juridike që lidhen me patentat e shpikjeve dhe modelet e përdorimit, marrëdhënie këto që aktualisht rregullohen nga ligji ekzistues nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji 9947”);

2. Sigurimi i një mbrojtjeje më të gjerë dhe më të fortë të patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë për shkak të rolit të madh që luajnë këto objekte të pronësisë industriale në aktivitetet e subjekteve vendas dhe të huaj;

3. Përafrimi i plotë i dispozitave ligjore për patentat me dispozitat e akteve përkatëse të Bashkimit Evropian, siç janë:

1. Ky ligj është përafruar me aktet e mëposhtme të Bashkimit Evropian: 1. Direktiva 98/44/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Korrik 1998 për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike (OJ L 213, 30.7.1998).

2. Direktiva 2004/48/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 29 Prill 2004 për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (OJ L 157, 30.4.2004).

3. Rregullorja (KE) Nr. 816/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 17 Maj 2006 për licensimin detyrues të patentave në lidhje me prodhimin e produkteve farmaceutike për eksport në vende me probleme të shëndetit publik OJ L 157, 9.6.2006 – në vijim: Rregullorja (KE) Nr. 816/2006).

4. Rregullorja (KE) Nr. 469/2009 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 6 Maj 2009 në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte mjekësore (OJ L 152, 16.6.2009).

5. Rregullorja (KE) Nr. 2019/933 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 20 Maj 2019 që amendon Rregulloren (KE) Nr. 469/2009 në lidhje me certifikatën e mbrojtjes shtesë për produkte mjekësore (OJ L 153, 11.6.2019).

6. Rregullorja (KE) Nr. 1610/96 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 23 Korrik 1996 në lidhje me krijimin e certifikatës së mbrojtjes shtesë për produktet e mbrojtjes së bimëve (OJ L 198, 8.8.1996).

7. Rregullorja (KE) Nr. 1901/2006 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 12 Dhjetor 2006 për produktet mjekësore për përdorim pediatrik dhe ndryshon Rregulloren (EEC) Nr. 1768/92, Direktivën 2001/20/EC, Direktivën 2001/83/EC dhe Rregulloren (KE) Nr. 726/2004.

8. Rregullorja (KE) Nr. 141/2000 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 16 Dhjetor 1999 për produktet mjekësore të sëmundjeve të rralla.

Plotësimi dhe mbushja e mangësive ligjore të vërejtura në praktikë gjatë ndjekjes së procedurave administrative në DPPI.

Përmbyshja e objektivave të strategjisë kombëtare të pronësisë intelektuale 2022-2025 për reformën ligjore dhe miratimin e ligjeve të veçanta për çdo objekt të pronësisë industriale.

Rregullimi i saktë dhe i detajuar i procedurave që lidhen me licensat sekrete dhe licensat detyruese apo vullnetare.

Rregullimi i plotë i marrëdhënieve juridike që lidhen me patentat e shpikjeve bioteknologjike.

Rregullimi i çështjeve dhe procedurave që lidhen me certifikatat e mbrojtjes shtesë për përdorim pediatrik.

Takime me grupet e interesit:

Pranë DPPI më datë 16.12.2023 zhvillua një takim në nivel teknik me përfaqësues të autorizuar të licencuar nga DPPI, të cilët në takim diskutuan mbi projektligjin dhe u orientuan, që çdo koment të bëhej në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike si dhe me e-mail, të cilat i gjeni të reflektuara në shtojcën 1, të këtij raporti.

Përfaqësuesit e autorizuar janë të gjithë persona të certifikuar nga DPPI që merren me aplikimet regjistrimin, ndryshimet në regjistër dhe ndjekjen e procedurave në Dhomën e Shqyrtimit të Kundërshtimeve, Dhomës për Shfuqizim/Zhvlerësim dhe në Bordin e Apelit, për objektet e pronësisë industriale.

Publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në linkun <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/431> si edhe publikimin në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Në regjistër kanë ardhur një numër I konsiderueshëm komentesh.

4. Palët e interesit të përfshira

Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka kryer konsultimin e brendshëm për këtë projektligj me grupet e interesit, përfaqësuesit e autorizuar dhe me organizatat ndërkombëtare, konkretisht me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), Zyrën Evropiane të Patentave (EPO).

Zyra është pajtuar me të gjitha ndryshimet e propozuara nga EPO dhe i pranojmë siç duhet. Gjithashtu nga WIPO është rekomanduar të ndiqet modeli holandez, opsioni "Të mos kërkohet një mendim me shkrim që shoqëron raportin e kërkimit". Janë dakordësuar ndryshimet e propozuar në nenin 159 dhe pranuar propozimin "të mos lejohen palët e treta të ndërhyjnë në procedurat para Bordit të Apelimit". DPPI ka bërë ndryshimet e nevojshme në lidhje me nenin për "Referencat për autoritetet joshqiptare". u ndryshua drafti dhe iu referuam ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë si autoriteti përkatës për miratimin e licencave të detyrueshme në Shqipëri.

Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Çështja e adresuar	Komentet për çështje me rëndësi	Palët e interesuara	Vendimi	Argumentet
Titulli i nenit 16	Titulli i nenit 16 të projektligjit të ndryshohet siç vijon: “Përfaqësimi në DPPI dhe ekspertët e patentave, modeleve të përdorimit dhe certifikatave të mbrojtjes shtesë.”	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	
Neni 16, pika 8 e projektligjit	Neni 16, pika 8 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “8. DPPI-ja është organi përgjegjës për licencimin e ekspertëve për patentat, modelet e përdorimit dhe certifikatat e mbrojtjes shtesë. Procedurat e licencimit dhe kushtet e veçanta për të ushtruar të drejtat e ekspertëve, si rregulla të tjera të detajuara në lidhje me ekspertët e patentave, përcaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave për ekspertët.”	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	

Neni 150, pika 2 e projektligjit	Neni 150, pika 2 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “2. Për qëllime të pikës 1 të këtij neni, çdo provë që mbështet mbrojtjen e patentës, modelit të përdorimit dhe certifikatës së mbrojtjes shtesë, shqyrtohet vlerësohet nga gjykata nëse ajo përbën provë që është në mënyrë të arsyeshme e mjaftueshme për provueshmërinë e pretendimeve të palës kërkuese	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	
Neni 151, pika 1 e projektligjit	Neni 151, pika 1 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “1. Edhe përpara fillimit të procedurave gjyqësore për themelin e çështjes, gjykata, me kërkesë të palës që ka paraqitur prova të mundshme që janë në mënyrë të arsyeshme të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e saj se të drejtat e patentës, modelit të përdorimit dhe certifikatës së mbrojtjes shtesë janë shkelur ose ka rrezik të shkelen,	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	

	mund të urdhërojë marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive për sigurimin e provës në lidhje me shkeljen e pretenduar, si dhe për shtrirjen dhe origjinën dhe destinacionin e saj, me kusht që të mbrohet informacioni konfidencial. Këto masa mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm të mallrave cenuese, me ose pa marrjen e mostrave, ose konfiskimin fizik të mallrave shkelëse dhe, sipas rastit, të materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin dhe/ose shpërndarjen e këtyre mallrave dhe dokumenteve të lidhura me to. Gjykata merr vendimin për të urdhëruar ose jo marrjen e masave për sigurimin e provës brenda pesë ditëve nga data e depozitimit të kërkesës, dhe përcakton afatin kohor brenda të cilit duhet të zbatohet masa e urdhëruar			
--	---	--	--	--

	nëpërmjet këtij vendimi. Ky afat kohor nuk duhet të jetë më shumë se pesë ditë nga data e marrjes së vendimit.”			
Neni 151, pika 2 e projektligjit	Neni 151, pika 2 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “2. Kur është e nevojshme, gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër, veçanërisht kur vonesa mund t’i shkaktojë dëme të pariparueshme mbajtësit të së drejtës ose kur ka rrezik të dukshëm që të shkatërrohet prova. Kur masat për sigurimin e provës vendosen pa dëgjuar palën tjetër, pala kundër së cilës është vendosur masa njoftohet menjëherë, jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës. Kur masat për sigurimin e provës janë vendosur pa i dhënë mundësi palës kundër së cilës është vendosur masa që të dëgjohej, kjo e fundit mund të depozitohet një kërkesë për rishikim të masës në gjykatë brenda pesë ditëve	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	

	nga data e njoftimit të masës. Në procedurat e rishikimit, gjykata i jep mundësi palëve që të dëgjohen dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave për sigurimin e provës brenda një afati kohor të arsyeshëm që nuk duhet të jetë më shumë se pesë ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.”			
Neni 151, pika 4 e projektligjit	Neni 151, pika 4 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: Me kërkesë të të paditurit, masat për sigurimin e provës shfuqizohen ose hiqen, pa cenuar të drejtën për dëmshpërblim që mund të pretendohet, nëse kërkuuesi nuk paraqet në gjykatë padinë për themelin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm të përcaktuar nga gjykata në vendimin e saj për marrjen e masave. Ky afat i arsyeshëm nuk mund të jetë më shumë se njëzetë ditë pune ose	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti pranohet	

	tridhjetë e një ditë kalendarike, cילו që është afati më i gjatë, nga data e ekzekutimit të masës për sigurimin e provës.			
Neni 153, pika 1 (c) e projektligjit	Neni 153, pika 1 (c) e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “c) Gjykata merr vendimin për të urdhëruar ose jo marrjen e masave të përkohshme brenda pesë ditëve nga data e depozitimit të kërkesës.”	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti pranohet	
Neni 153, pika 5 e projektligjit	Neni 153, pika 5 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: 5. Kur është e nevojshme, gjykata vendos për marrjen e këtyre masave pa dëgjuar palën tjetër, veçanërisht kur vonesa mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për mbajtësin e së drejtës. Në një rast të tillë, palët informohen menjëherë, por jo më vonë se në fillim të ekzekutimit të masës.”	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti u pranua	

Neni 153, pika 6 e projektligjit	Neni 153, pika 6 e projektligjit të ndryshohet siç vijon: “6. Kur masat e përkohshme janë vendosur pa i dhënë mundësi palës kundër së cilës është vendosur masa që të dëgjohej, kjo e fundit mund të depozitojë një kërkesë për rishikim të masës në gjykatë brenda pesë ditëve nga data e njoftimit të masës së përkohshme. Në procedurat e rishikimit, gjykata i jep mundësi palëve që të dëgjohej dhe konfirmon, ndryshon ose shfuqizon vendimin që urdhëron marrjen e masave të përkohshme brenda një afati kohor të arsyeshëm që nuk duhet të jetë më shumë se pesë ditë nga data e depozitimit të kërkesës për rishikim.”	Përfaqësuesit e autorizuar	Komenti pranohet	
Neni 13, pika 1	Po ne rastet kur shpikësi apo zëvendësuesi ligjor janë persona natyrale (jo fizike apo juridike) kujt i përket e drejta ?	EUROMARK PAT ALBANIA		Shpikësi është gjithmonë individ.
Neni 18, pika 2	Cili është ndryshimi ndërmjet tarifës administrative dhe asaj procedurale?	EUROMARK PAT ALBANIA		Nuk ka dy lloje tarifash; është shkruar gabimisht. Pra, do të ketë vetëm “tarifë” dhe

	Do aplikohen 2 lloje tarifash?			ky saktësim u reflektua ne projektligj.
Neni 24, pika 5	Nuk është përcaktuar procedura e inspektimit: si kryhet dhe cilat janë kërkesat.	EUROMARK PAT ALBANIA		Neni 24 parashikon te drejtën për të kërkuar inspektim. Procedura e inspektimit do te parashikohet ne rregulloren për patentat. Ky ndryshim u reflektua ne projektligj.
Neni 58	Duhet parashikuar mundësia e ankimimit ndaj vendimit te refuzimit	EUROMARK PAT ALBANIA		Po, është parashikuar ne nenin 87 te projektligjit.
Neni 68	Duhet parashikuar mundësia e ankimi mit ndaj vendimit te refuzimit.	EUROMARK PAT ALBANIA		Po, është parashikuar ne nenin 87 te projektligji
Neni 75, pika 2	Ne vijim duhet te radhiten kushtet, sepse ndryshe nuk përcillet qarte kuptimi i këtij neni. Veprimet qe janë përjashtim duhet te jene te veçuara nga kushtet qe i lejojnë këto veprime.	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 79, pika 8	Pika 4 i referohet datës se depozitimit.	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	Pika 4 është vendosur gabimisht. U korrigjua “sipas pikës 5” dhe u reflektua ne projektligj.
Neni 102, pika 1	Duhet riformuluar kjo pike sepse nuk e përcjell kuptimin. Ose te sqarohet se kush nuk përfiton nga këto te drejta ekskluzive.	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 117, pika 5	Kush i mbart kostot ne një rast te tille?	EUROMARK PAT ALBANIA		Kjo është pjese e procedurës se Doganave dhe Vendimit te Këshillit te Ministrave për

				ndalimin e mallrave ne dogane.
Neni 121, paragrafi 1	Si ta kuptojmë këtë “te mundësoje”? Mund te paraqesë, apo mund te mos paraqesë?	EUROMARK PAT ALBANIA		U ndryshua dhe u reflektua ne projektligj.
Neni 123, pika 2	Me mire të përdoret termi përgjithësues “akti”, sepse “kontrata” është shume kufizuese, dhe nga praktika jo gjithnjë paraqitet kontrate, por ka edhe akt transferimi, edhe certifikatë bashkimi/ndarjeje etj.	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 123, pika 3, germa iii)	Te shtohet përveç ekstraktit, edhe certifikata e bashkimit/ndarjes pasi praktika ka treguar se paraqitet nga aplikanti/pronari edhe një dokument i tille	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 124, pika 5	Aplikimi për licence behet edhe për aplikime? Apo me kushtin qe aplikimi te përfundoje me sukses?	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 124, pika 7	Kjo pike duhet te jete pjese e nenit 123 sepse i referohet transferimit.	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
Neni 134, pika 2, germa ç)	Pse duhen paguar tarifa procedurale ne favor te DPPI-së për përkthimin, kur këtë gjë e kryen dhe e mbart aplikanti?	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	U korrigjua dhe u reflektua saktësimi ne projektligj.

Neni 159, pika 1:	Termi “mund” është kufizues. Te shënohet “janë objekt”	EUROMARK PAT ALBANIA	Komenti u pranua	
----------------------	---	----------------------------	------------------	--